



Prishtinë: 29.03.2018

Kodi i ZRRE-së: V_955_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1593_07_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **29.08.2017**

në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin L.U, nga Prishtina, me shifër të konsumatorit **DMI - 9005139** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1593_07_17 i datës 07.07.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 29.08.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Njehsori i vendosur me datë 20.11.2015 ka qenë në gjendje A1=0 kWh dhe A2=0 kWh sipas procesverbalit të ndërrimit të njehsorit dhe se dhe fatura e muajit 02/2016 është si pasojë e mos leximit të njehsorit nga periudha 12/2015 e deri më 02/2016 dhe me këtë janë grumbulluar kWh për këta 3 muaj dhe edhe po që sa bëhet shpërndarja atëherë prapë nuk do ka elemente të korigjimit për shkak se është konsumator 7/02. Gjithashtu nuk mund të argumentohet se lokali nuk ku punuar pasi ka mundur të bëjë renovim dhe ka mundur të shpenzoj energji elektrike. Gjithashtu është dashur të bëhen krahasime në periudha të ndryshme dhe jo vetëm në periudha të caktuara.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloj vendimin e DMK/ZRRE _V_1593_07_17, në lidhje me shifrën DMI - 9005139 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se korigjimi i datës 04.06.2015 është në përputhshmëri me dispozita ligjore të rregullave në fuqi, për Bordin pretendimet të tilla janë



vlerësuar si të paqëndrueshme për faktin se nga analiza e bërë rrjedhës së energjisë elektrike të konsumatorit, KESCO nuk ka arritur të argumentojë me asnjë provë se konsumatori ka bërë shpenzimin e ngarkuar nga KESCO.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se konsumatori me shifër DMI – 9005139 gjatë periudhës 09/2013 e deri më 11/2014 nuk ka asnjë të dhënë të evidentuar në transaksionet e konsumatorit, pra sipas të dhënave kjo shifër gjatë kësaj periudha ka qenë e pasivizuar. Për këtë çështje edhe organi i shkallës së parë ka kërkuar informata lidhur me procesverbalin e KEDS rreth pasivizimit të kësaj shifre, por që KEDS nuk ka ofruar asnjë dokument rreth pasivizimit të kësaj shifre gjatë periudhës 09/2013 dhe 11/2014.

Bordi i ZRRE gjithashtu gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se KESCO me datë 10.12.2014 përmes udherlejimit ka bërë kontestimin e borxhit të energjisë elektrike në vlerë prej -2,673.38€, pasi që lokalit në fjalë me datë 30.06.2014 është blerë nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP) përmes procesit të privatizimit.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka analizuar listat e leximit të KEDS-it për konsumatorin prej periudhës kohore 10/2015 deri më 03/2016 dhe nga këto shihet se pika matëse e konsumatorit është lexuar me rregull dhe nuk ka ndonjë parregullsi në lexim. Duhet theksuar se në muajt 10/2015, 11/2015 dhe 12/2015 lexuesi i KEDS-it në listat e leximit ka evidentuar se njehsori është brenda, por pa shpenzime, ndërsa në muajt tjerë në vazhdim nuk ka evidentuar se ka qasje apo jo por vetëm ka evidentuar shpenzimin në njehsor.

Sa i përket pikës së kundërshtimit rreth krahasimit të shpenzimeve të energjisë elektrike, Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit dhe se ka vërejtur se shpenzimi i faturuar i muajit 02/2016 prej prej **3,979 kWh** nuk përputhet me shpenzimin e konsumatorit. Bordi i ZRRE ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike në periudha të ndryshme dhe thekson se mesatarja mujore e shpenzimit të njehsorit elektik pas periudhës kontestuese nga periudha 03/2016 deri me 04/2017 rezulton se është **212 kWh/muaj**, pra shihet qartë se kemi mos përputhje të shpenzimit mes këtyre periudhave. Gjithashtu është analizuar edhe shpenzimi i përgjithshëm i energjisë elektrike i njehsorit nr.64673625 për periudhën 03/2016 - 04/2017 dhe e cila pas analizave del se është **2,952 kWh** (periudha pas kontestit), ndërsa vetëm fatura mujore 02/2016 ka qenë me shpenzim prej **3,979 kWh**, pra qartë tregon se se kemi mos përputhje të shpenzimit mes këtyre periudhave. Vlen të theksohet se Bordi ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike edhe sipas sezonave dhe prapë ka vërejtur se ka mos përputhje të shpenzimit të muajve tjerë me periudhën kontestuese (02/2016).

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja”*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore mund të konstatojmë se në rastin konkret konsumatori ka pasur obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar, por që jo të ngarkohet me një vlerë shumë të lartë e cila ka mund të jetë për shkak të problemeve teknike në njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit L.U. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së